


# Kompensimi për Papunësi në Bujqësi

## Indennità di Disoccupazione Agricola





## Je i punësuar në bujqësi dhe je pushuar nga puna ose kontratës tënde i ka skaduar afati?

Mund të kesh të drejtën e kompensimit për papunësi në bujqësi kërkesën duhet ta bësh brenda datës **31 mars**

### Kush janë punëtorët e interesuar?

- ✓ Punëtorët me kohë të përcaktuar (O.T.D.).
- ✓ Punëtorët me kohë të papërcaktuar (O.T.I.).

Në qoftë se je punonjës imigrant duhet të kesh lejeqëndrim për punë të varur, ose në pritje për punësim.

### Në cilat raste e ke të drejtën e kompensimit për papunësi?

- ✓ Pushim nga puna.
- ✓ Mbarim i afatit të kontratës.

Nëse je punonjës imigrant me marrëdhënie të varura pune dhe e ke humbur vendin e punës, mund të regjistrohesh në listat emërore të punës të Qendrës për Punësim, për periudhën e vlefshme të mbetur të lejeqëndrimit e gjithësesi për të paktën një vit.

Mos harro se, për pritje punësimi, mund të marrësh lejeqëndrim, i cili mund të ripërtërihet. Para skadimit të lejeqëndrimit tënd, kalo nga zyrat tona për të mësuar të gjitha informacionet e nevojshme.

### Mund të kesh të drejtën e shërbimeve të mëposhtme

- ✓ Kompensim për papunësi në bujqësi: kërkesa i duhet paraqitur Inps-it vetëm në mënyrë telematike. Ky veprim mund të bëhet pranë zyrave tona.

### Kur mund ta paraqesësh kërkesën?

- ✓ Kërkesa duhet paraqitur brenda datës **31 mars** të vitit pas atij të pushimit nga puna ose të skadimit të afatit të kontratës.
- ✓ Pra, brenda **31 marsit** duhet të paraqesësh kërkesën për kompensim për vitin e mëparshëm, përndryshe e humb të drejtën.

### Në cilat raste nuk e ke të drejtën e kompensimit për papunësi?

- ✓ Dorëheqje e vullnetshme nga puna (përveç, në kushte të përcaktuara saktë, punonjëseve nëna gjatë vitit të parë të fëmijës).
- ✓ Në rast se je punonjës imigrant me lejeqëndrim për punë stimore (nga 20 ditë deri në 9 muaj, por me detyrimin e rikthimit në atdhe).

Për informacione të mëtejshme dhe për të përpiluar formularin përkatës drejtohu në selinë e FAI-CISL ose në zyrat e INAS-CISL